

Hapet thirrja për bursa në kuadër të Programin Erasmus+ KA 2, për projektin K-Force për semestrin e parë të vitit akademik 2018-2019

Universiteti i Tiranës hap thirrjen për aplikime për bursa mobiliteti për mësimdhënie dhe trajnim në kuadër të projektit K-Force Erasmus+ KA 2 në :

- Universitetin e Novi Sad-it, Serbi (mësimdhënie);
- Universitetin e Banja Lukës; Bosnje dhe Hercegovinë (mësimdhënie);
- Shkollën e Lartë Teknike të Novi Sad-it, Serbi (mësimdhënie);
- Universitetin e Zilinës, Sllovaki (trajnim);

Llojet e mobilitetit përfshijnë:

-Shkëmbimin e stafit akademik për mësimdhënie, i cili merret me manaxhimin e projektit K-Force;

-Shkëmbimin e stafit akademik për trajnim, i cili merret me manaxhimin e projektit K-Force;

Bursat do të mbulohen nga fondet e projektit K-Force dhe do të përfshijnë:

-Kompensim ditor;

-Kostot e udhëtimit;

Dokumentat e nevojshme për aplikim për stafin akademik për mësimdhënie/trajnim:

- CV+ Lista e publikimeve (në gjuhën angleze);

- Kopje e Pasaportës;

- Letër motivimi (në gjuhën angleze);

- Vërtetim Punësimi (në gjuhën shqipe);

- Certifikata e gjuhës së huaj B2 (Anglisht);

- Plani i mobilitetit për mësimdhënie/trajnim*;

Për të shkarkuar formatin e Planit të Mobilitetit për Mësimdhënie klikoni në adresën:

http://www.unitir.edu.al/images/Bursat/Teaching_Mobility_Plan.pdf

Për të shkarkuar formatin e Planit të Mobilitetit për Trajnim klikoni në adresën:

http://www.unitir.edu.al/images/Bursat/Training_Mobility_Plan.pdf

*Plani i Mobilitetit është një dokument në të cilin duhet të specifikohet programi juaj i propozuar që do të kryeni gjatë periudhës së shkëmbimit. Ky dokument firmoset nga aplikanti dhe nga personi përgjegjës në Rektorat i cili është Koordinatori Institucional i Erasmus +, Z. Elton Skendaj.

Afati për aplikim: 12 Nëntor 2018

Dokumentet duhen dorëzuar dorazi në Rektoratin e Universitetit të Tiranës, Drejtoria e i Marrëdhënieve me Jashtë dhe Studentët, Sektori i Marrëdhënieve me Jashtë si dhe duhet të dërgohen të skanuara në e-mailin iro@unitir.edu.al me subjekt, emrin dhe mbiemrin tuaj si dhe universitetin në të cilin po aplikoni.

Për më shumë informacion mbi bursat mund të na kontaktoni në adresën: iro@unitir.edu.al

Universiteti i Tiranës ju uron suksese në aplikim!